REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA I FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE
DREJTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU
Nr.ia/Br.str. 75
Data/Datum 04. 05. 2017
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE

**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA**
**REPUBLIC OF KOSOVA**

Fushë kosova

**KOMUNA E FUSHË–KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE**
**MUNICIPALI TY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE**

**Datë: 04.05.2017**

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 28.04.2017, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 409, të datës 28.04.2017, në lidhje me kërkesën Nr. 06-005-11918, të datës 30.03.2017, e paraqitur nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, bazuar në nenin 11, nenin 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, nenin 13, paragrafi 3, të 'Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve' Nr. 83, të datës 14.06.2013, mori:

# V E N D I M

## Për lejimin e mjeteve financiare për ndihmë në shërim dhe trajtim shëndetësor për palën Festim Kadri Pllana nga fshati Bardh i Madh

1. Për lejimin e mjeteve financiare, në shumë prej 7000€, për palën Festim Kadri Pllana nga fshati Bardh i Madh, me destinim për të ndihmuar në mbulimin e shpenzimeve për intervenim dhe trajtim shëndetësor nga sëmundja me: Dg. St. post amputatio extremitas superior dex; St. post amputatio extremitas inferior regio femoris dex; St. post VLC capitis et facei regio bucalis dex.

2. Është në kompetencë të Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit që të sigurojë mjetet financiare sipas pikës një (1) të vendimit.

3. Mjetet financiare të lejuara sipas pikës një (1) të vendimit, për shërimin e Festim Kadri Pllana, lejohen të barten në xhirollogarinë e vëllait, Enis Kadri Pllana nga fshati Bardh i Madh, me Nr. 1501001016103450, në Raiffeisen Bank.

4. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera, për zbatimin e këtij vendimi, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit.

5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së SHMS, Drejtorisë së FB, Palës dhe Arkivës.**

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**
**Dr. sc. Fadil Krasniqi**

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - KUVENDI I KOMUNËS - SKUPŠTINA OPŠTINA KOSOVO POLJE
FUSHË-KOSOVË KOSOVO POLJE

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË KOSOVËS / OPSTINA KOSOVO POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË KOSOVË / KOSOVO POLJE

Nr.tag/Br.stc. 75
Datë/Datum. 04.05.2017
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE

Datum 04.05.2017

Skupstina Opstine na sastanku odrzanog dana 28.04.2017 posle razmatranja predloga br. 409 dana 28.04.2017 godine, u vezi zahteva br. 06-005-11918 dana 30.03.2017, predstavljenog od Direkcije za Zdravstvo i Socijalna Pitanja, oslanjajuci se na clan 11, clan 40 Zakona o Lokalnoj Samoupravi br. 03/L-040 (Sluzbeni List br. 28/2008), clan 27 Opstinskog Statuta br. 98 dana 17.08.2012, clan 13 paragraf 3 Pravilnika o Raspodeli Subvencija" br. 83 dana 14.06.2013 donosi:

ODLUKU

**O odobrenju finansijskih sredstava za zdravstvenu pomoc i tretman za stranku Festim (Kadri) Pllana iz sela Veliki Belacevac**

1. Za odobrenje finansijskih sredstava u iznosu od 7000 € za stranku Festim (Kadri) Pllana iz sela Veliki Belacevac sa destinacijom za pokrivanje troskova za intervenciju i zdravstveni tretman od bolesti: Dg. St. post ampulatio exttremitas superior dex; St. post ampulatio extremitas inferior region femoris dex; St. post VLC capitis et facei region bucalis dex.
2. Direkcija za Budzet i Finansije je nadlezna da osigura finansijska sredstva iz tacke jedan (1) ove odluke.
3. Finansijska sredstva odobrena iz tacke jedan (1) ove odluke za lecenje Festim (Kadri) Pllana odobravaju se i prenose na ziroracun brata Enis (Kadri) Pllana iz sela Veliki Belacevac se brojem: 1501001016103450 Raiffeisen Bank.
4. Izvrsavanje i nadzor ostalih procedura za primenu ove odluke su nadlezni Direkcija za Zdravstvo i Socijalna Pitanja i Direkcija za Budzet i Finansije.
5. Ova odluka stupa na snagu 15 dana posle upisa na protokol Ministarstva Administracije Lokalne Samouprave kao i objavljivanja na sluzbenim jezicima na web stranici Opstine.

**Akt da se prosledi: Gradonacelniku Opstine, Predsedavajuceg Skupstine Opstine, Direkciji za ZSP, Direkcijiza FB, Stranki i Arhivi.**

**Predsedavajuci Skupstine Opstine**
**Dr. sc. Fadil Krasniqi**

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE
DREJTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU
Nr.fag/Br.str. 76
Datë/Datum. 08.05.2017
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË–KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

**Datë: 05.05.2017**

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 28.04.2017, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 20, të datës 10.02.2017, në lidhje me kërkesën Nr. 02-016-1666, të datës 25.01.2017, e paraqitur nga Drejtoria e Planifikimit Urban, bazuar në nenin 11, nenin 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

# V E N D I M

**Për plotësimin e vendimit Nr. 30, të datës 09.03.2017 dhe aprovimin e kërkesës për ndërrimin e destinimit për realizimin e projektit për 'Riciklimin, ambalazhimin dhe asgjësimin e mbeturinave' për subjektin afarist Princi Compani.**

1. Aprovohet 'Propozimi për plotësimin e vendimit Nr. 30, të datës 10.03.2017', për lejimin e ndërrimit të destinimit nga zona pyjore gjelbëruese në zonë ndërtimore, sipas kërkesës Nr. 02.016-1666, të datës 25.01.2017, për Ngastrën Kadastrale Nr. P-72514003-00779-5, sipërfaqja e përgjithshme prej 20000m², pronë private, me posedues nga qirambajtja për 99 vjet, në emër të Istref (Sejdi) Elshani, në Zonën Kadastrale Harilaç, evidentuar në certifikatën e pronës 14-095-39002, me destinim për realizimin e projektit për 'Riciklimin, ambalazhimin dhe asgjësimin e mbeturinave', nga subjekti afarist Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuara 'Princi Compani', investitor Avni (Sali) Barani'.

2. Realizimi i projektit për 'Riciklimin, ambalazhimin dhe asgjësimin e mbeturinave', nga subjekti afarist Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuara 'Princi Compani', investitor Avni (Sali) Barani, ndikon në rritjen e zhvillimit ekonomik, gjenerimin e vendeve të punës dhe nuk pengon në projektet zhvillimore të Komunës së Fushë-Kosovës'.

3. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera, për zbatimin e këtij vendimi, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Planifikimit Urban, Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Mjedisit dhe Drejtorisë së Inspektoratit.

4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së PU, Drejtorisë së BZHR, Drejtorisë së SHPM, Drejtorisë së INSPK, Palës dhe Arkivës.**

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**
**Dr.sc. Fadil Krasniqi**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË KOSOVËS / OPSTINA KOSOVO POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË KOSOVË / KOSOVO POLJE

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË KOSOVËS OPSTINA KOSOVO POLJE
DREJTORIA ... ZA ADMINISTRACIJU
Nr.faq/Br.str 76
Datë/Datum 08.05.2017
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE

Datum 05.05.2017

Skupstina Opstine na sastanku odrzanog dana 28.04.2017 posle razmatranja predloga br. 20 dana 10.02.2017 godine, u vezi zahteva br. 02-016-1666 dana 25.01.2017, predstavljenog od Direkcije za Urbanisticko Planiranje, oslanjajuci se na clan 11, clan 40 Zakona o Lokalnoj Samoupravi br. 03/L-040 (Sluzbeni List br. 28/2008), clan 27 Opstinskog Statuta br. 98 dana 17.08.2012, donosi:

# ODLUKU

**O dopuni odluke br. 30 dana 09.03.2017 i usvajanje zahteva za izmenu destinacije za realizaciju projekta za ricikliranje, ambalizu i eliminaciju smeca za poslovni subjekat "Prince Company"**

1. Usvaja se predlog za dopunu odluke br. 30 dana 10.03.2017 godine za odobrenje izmene destinacije iz zelene sumske zone u zone za izgradnju po zahtevu br. 02-016-1666 dana 25.01.2017 za parcel br. P-72514003-00779-5, ukupna povrsina od 20000 m2, privatna svojina sa posediocem iz zakupa za 99 godina na ime Istref (Sejdi) Elshani u Katastarskoj Zoni Harilaç, evidentirana na certifikat br. 14-095-39002, sa destinacijom za realizaciju projekta za ricikliranje, ambalazu i eliminaciju smeca od strane poslovnog subjekta Drustvo za Ogranicenim Mogucnostima "Prince Company" investitor Avni (Sali) Barani.
2. Realizacija projekta za ricikliranje, ambalazu i eliminaciju smeca od poslovnog subjekta Drustvo za Ogranicenim Mogucnostima "Prince Company" investitor Avni (Sali) Barani, utice na povecanju ekonomskog razvoja, generisanje radnih mesta i ne smeta razvojne projekta Opstine Kosovo Polje.
3. Izvrsavanje i nadzor ostalih procedura za primenu ove odluke su nadlezni Gradonacelnik Opstine, Direkcija za Urbanisticko Planiranje, Direkcija za Javne Usluge i Okolinu i Direkcija za Inspekciju.
4. Ova odluka stupa na snagu 15 dana posle upisa na protokol Ministarstva Administracije Lokalne Samouprave kao i objavljivanja na sluzbenim jezicima na web stranici Opstine.

**Akt da se prosledi: Gradonacelniku Opstine, Predsedavajuceg Skupstine Opstine, Direkciji za UP, Direkciji za PRR, Direkciji za JUO, Direkciji za INSP, Stranki i Arhivi.**

**Predsedavajuci Skupstine Opstine**
**Dr. sc. Fadil Krasniqi**

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE
DREJTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ADMINISTRACIJE
Nr.faq/Br.str. 77
Datë/Datum. 11.05.2017
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE

**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA**
**REPUBLIC OF KOSOVA**

**KOMUNA E FUSHË–KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE**
**MUNICIPALI TY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE**

**Datë: 05.05.2017**

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 28.04.2017, pas shqyrtimit të Kërkesës Nr. 1539-2/17, të datës 04.04.2017, për rishqyrtimin e ligjshmërisë së vendimit Nr. 41, të datës 15.03.2017, bazuar në nenin 11, nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 22, të Ligjit për Ndërtim Nr. 04/L-110 (Gazeta Zyrtare Nr. 18/2012), nenin 6, paragrafi 2, të Udhëzimit Administrativ Nr. 22/2012, mbi Taksat Administrative për Lëshimin e Lejes së Ndërtimit dhe Tarifat për Rregullimin e Infrastrukturës nenin 27, shkronja (nj), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

**V E N D I M**

**Për aprovimin e 'Kërkesës Nr. 1539-2/17, të datës 04.04.2017, për rishqyrtimin e ligjshmërisë së vendimit Nr. 41, lidhur me ndryshimin e pikës dy (2) të vendimit Nr. 41, të datës 15.03.2017'.**

1. Për aprovimin e 'Kërkesës Nr. 1539-2/17, të datës 04.04.2017, për rishqyrtimin e ligjshmërisë së vendimit Nr. 41 dhe ndryshimin e pikës dy (2) të vendimit, të datës 15.03.2017, për caktimin e taksës komunale për lëshimin e lejeve ndërtimore dhe përmirësimin e tekstit të saj si vijon, aprovohet: 'Propozimi për caktimin e tarifës rregulluese për rritjen e densitetit për vitin 2017, për lëshimin e lejeve ndërtimore, në shumë prej 2.40€ për një metër katror dhe aplikimin e saj vetëm për njësitë e reja të banimit, konform nenit 6, paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ Nr. 22/2012 mbi Taksat Administrative për Lëshimin e Lejes së Ndërtimit dhe Tarifat për Rregullimin e Infrastrukturës'.

2. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë së Planifikimit Urban.

3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së PU dhe Arkivës.**

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**
**Dr.sc. Fadil Krasniqi**

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO OPŠTINA KOSOVO POLJE

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË KOSOVËS / OPSTINA KOSOVO POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË KOSOVË / KOSOVO POLJE

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
Nr.faq/Br.str. 77
Date/Datum. 11.05.2017
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE

Datum 05.05.2017

Skupstina Opstine na sastanku odrzanog dana 28.04.2017 posle razmatranja zahteva br. 1539-2/17 dana 04.04.2017 godine, za razmatranje zakonitosti odluke br. 41 dana 15.03.2017, oslanjajuci se na clan 11, clan 40 paragraf 40.2 slovo (I) Zakona o Lokalnoj Samoupravi br. 03/L-040 (Sluzbeni List br. 28/2008), clan 22 Zakona o Izgradnji br. 04/L-110 (Sluzbeni List br. 18/2012), clan 6 paragraf 2 Administrativnog Uputstva br. 22/2012 o Admninistrativnim Taksama za izdavanje Dozvole za Izgradnju i Tarifama za Regulisanje Infrastrukture, clan 27 slovo (nj) Opstinskog Statuta br. 98 dana 17.08.2012, donosi:

# ODLUKU

**Za usvajanje zahteva br. 1539-2/17 dana 04.04.2017 za ponovno razmatranje zakonitosti odluke br. 41 dana 15.03.2017 u vezi izmene tacke dva (2) odluke br. 41 dana 15.03.2017**

1. Za usvajanje zahteva br. 1539-2/17 dana 04.04.2017 za ponovno razmatranje zakonitosti odluke br. 41 dana 15.03.2017 i izmene tacke dva (2) odluke dana 15.03.2017 za odredjivanje Opstinske takse za izdavanje dozvole za izgradnju i ispravku njenog teksta kao: usvaja se predlog za odredjivanje regulativne tarife za povecanje densiteta za 2017 godinu za izdavanje dozvole za izgradnju u iznosu od 2.40 € za kvadratni metar i apliciranje samo za nove jedinice stanovanja u skladu sa clanom 6 paragraf 2 Administrativnog Uputstva br. 22/2012 o Administrativnim Taksama za izdavanje dozvole za izgradnju i tarifama za regulisanje infrastructure.
2. Izvrsavanje i nadzor ostalih procedura za primenu ove odluke je u nadleznosti Gradonacelnika Opstine i Direkcije za Urbanisticko Planiranje.
3. Ova odluka stupa na snagu 15 dana posle upisa na protokol Ministarstva Administracije Lokalne Samouprave kao i objavljivanja na sluzbenim jezicima na web stranici Opstine.

**Akt da se prosledi: Gradonacelniku Opstine, Predsedavajuceg Skupstine Opstine, Direkciji za UP i Arhivi.**

**Predsedavajuci Skupstine Opstine**
**Dr. sc. Fadil Krasniqi**

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE
DREJTORIA E ADMINISTRATËS - UPRAVA ZA ADMINISTRACIJU
Nr.faq/Br.str. 78
Datë/Datum 11.05.2017
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE

**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA**
**REPUBLIC OF KOSOVA**

Fushë kosova

**KOMUNA E FUSHË–KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE**
**MUNICIPALI TY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE**

**Datë: 05.05.2017**

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 28.04.2017, pas shqyrtimit të Kërkesës Nr. 1543-2/17, të datës 04.04.2017, për rishqyrtimin e ligjshmërisë së vendimit Nr. 48, të datës 15.03.2017, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (d), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, shkronja (nj), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

# V E N D I M

**Për aprovimin e 'Kërkesës Nr. 1543-2/17, të datës 04.04.2017, për rishqyrtimin e ligjshmërisë së vendimit Nr. 48, të datës 15.03.2017 dhe shfuqizimin e pikës dy (2) të vendimit Nr. 48, të datës 15.03.2017'.**

1. Për aprovimin e 'Kërkesës Nr. 1543-2/17, të datës 04.04.2017, për rishqyrtimin e ligjshmërisë së vendimit Nr. 48, të datës 15.03.2017 dhe shfuqizimin e pikës dy (2) të vendimit Nr. 48, të datës 15.03.2017', lidhur me formimin e Komisionit nga Kuvendi i Komunës, në përbërje prej shtatë (7) anëtarëve, për realizimin e procedurave të shpronësimit'.

2. Realizimi i procedurave të shpronësimit bëhet në përputhje me dispozitat ligjore të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme Nr. 03/L-139, ndryshim-plotësimin e Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme Nr. 03/L-205 dhe Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, përmes caktimit të një Autoriteti tjetër Publik Komunal, për të vepruar si Organ Shpronësues i Komunës, me vendimin e Kryetarit të Komunës.

3. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi dhe realizimin e procedurave të shpronësimit është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, përmes marrjes së vendimit për miratimin e kërkesës për shpronësim, mbajtjes së dëgjimit publik, vlerësimit të pronave të paluajtshme nga organi kompetent - Ministria e Financave, marrjen e vendimit preliminar të shpronësimit dhe vendimit përfundimtar për shpronësim, konform pikës dy (2) të vendimit.

4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së PU, Drejtorisë së GJKP, Drejtorisë së SHPM dhe Arkivës.**

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**
**Dr.sc. Fadil Krasniqi**

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE
KUVENDI
FUSHË-KOSOVË KOSOVO POLJE

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË KOSOVËS / OPSTINA KOSOVO POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË KOSOVË / KOSOVO POLJE

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE
Nr.lag/Br.str. 78
Datë/Datum. 11. 05. 2017
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE

Datum 05.05.2017

Skupstina Opstine na sastanku odrzanog dana 28.04.2017 posle razmatranja zahteva br. 1543-2/17 dana 04.04.2017 godine, za razmatranje zakonitosti odluke br. 48 dana 15.03.2017, oslanjajuci se na clan 11, clan 12 paragraf 12.2 slovo (d), clan 40 paragraf 40.2 slovo (I) Zakona o Lokalnoj Samoupravi br. 03/L-040 (Sluzbeni List br. 28/2008), clan 27 slovo (nj) Opstinskog Statuta br. 98 dana 17.08.2012, donosi:

# O D L U K U

**Za usvajanje zahteva br. 1543-2/17 dana 04.04.2017 za ponovno razmatranje odluke br. 48 dana 15.03.2017 i ukidanje tacke dva (2) odluke br. 48 dana 15.03.2017**

1. Za usvajanje zahteva br. 1543-2/17 dana 04.04.2017 za ponovno razmatranje zakonitosti odluke br. 48 dana 15.03.2017 i ukidanje tacke dva (2) odluke br. 48 dana 15.03.2017 u vezi formiranja komisije od strane Skupstine Opstine u sastavu od sedam (7) clanova za realizaciju procedura ekspropriacije.
2. Realizacija procedura ekspropriacije vrsi se u skladu sa zakonskim dispozicijama Zakona o Ekspropriaciji Nepokretnine br. 03/L-139 izmena-dopuna Zakona o Ekspropriaciji Nepokretnine br. 03/L-205 Zakona o Lokalnoj Samoupravi br. 03/L-040 preko odredjivanja jednog drugog Opstinskog Javnog Autoriteta da bi delovao kao Ekspropriativni Organ Opstine sa odlukom Gradonacelnika Opstine.
3. Izvrsavanje i nadzor ostalih procedura za primenu ove odluke i ralizacija procedura ekspropriacije je u nadleznosti Gradonacelnika Opstine preko donosenja odluke za usvajanje zahteva za ekspropriaciju, odrzavanja javne rasprave, ocenjivanja nepokretnina od ovlascenog organa, Ministarstvo Finansija, donosenja preliminarne odluke o ekspropriaciji i zavrsne odluke za ekspropriaciju u skladu sa tackom dva (2) odluke.
4. Ova odluka stupa na snagu 15 dana posle upisa na protokol Ministarstva Administracije Lokalne Samouprave kao i objavljivanja na sluzbenim jezicima na web stranici Opstine.

**Akt da se prosledi: Gradonacelniku Opstine, Predsedavajuceg Skupstine Opstine, Direkciji za UP, Direkciji za GKI, Direkciji za JUO i Arhivi.**

**Predsedavajuci Skupstine Opstine**
**Dr. sc. Fadil Krasniqi**

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE
DREJTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU
Nr.faq/Br.str. 79
Datë/Datum. 11.05.2017
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE

**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA**
**REPUBLIC OF KOSOVA**

Fushë kosova

**KOMUNA E FUSHË–KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE**
**MUNICIPALI TY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE**

**Datë: 05.05.2017**

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 28.04.2017, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 348, të datës 05.04.2017, të paraqitur nga Drejtoria e Arsimit, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 17, shkronja (h), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (c, l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 6, nenin 7, të Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin për të Rritur Nr. 04/L-143 (Gazeta Zyrtare Nr. 02/2013), nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (ë), nenin 27, shkronja (ç, nj), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

# V E N D I M

## Për aprovimin e 'Propozimit Nr. 348, të datës 05.04.2017, për shfrytëzimin e mjeteve financiare të mësimit joformal'.

1. Aprovohet 'Propozimi për hapjen e linjës buxhetore në kategorinë ekonomike 11 për rroga dhe paga'.

2. Mjetet financiare, në shumë të përgjithshme prej 18,597.24€, si të hyra vetjake në arsim, destinohen për pagesat e arsimtarëve dhe stafit arsimor që kanë zhvilluar dhe zhvillojnë procesin mësimor, mbajtjen e provimeve nga mësimi joformal dhe alokohen në kategorinë ekonomike 11 në arsimin e mesëm si vijon: në arsim të mesëm për Shkollën e Mesme Teknike 'Minatori' - kodi i programit Nr. 94231, shuma 4,920.34€, në arsim të mesëm për Shkollën e Mesme Ekonomike 'Hoxhë Kadri Prishtina' - kodi i programit Nr. 94232, shuma 6,948.22€ dhe në arsim të mesëm për Shkollën e Mesme 'Hivzi Sulejmani' - kodi i programit Nr. 94233, shuma 6,728.68€.

3. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit dhe Drejtorisë së Arsimit.

4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së FB, Drejtorisë së Arsimit dhe Arkivës.**

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**
**Dr.sc. Fadil Krasniqi**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË KOSOVËS / OPSTINA KOSOVO POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË KOSOVË / KOSOVO POLJE

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE
Nr.faq/Br.str. 79
Date/Datum. 11-05-2017
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE

Datum 05.05.2017

Skupstina Opstine na sastanku odrzanog dana 28.04.2017 posle razmatranja predloga br. 348 dana 05.04.2017 godine, predstavljenog od strane Direkcije za obrazovanje, razmotrenog na Komitetu za Politiku i Finansije i Komitetu za Zajednice, oslanjajuci se na clan 11, clan 17 slovo (h), clan 40 paragraf 40.2 slovo (c,I) Zakona o Lokalnoj Samoupravi br. 03/L-040 (Sluzbeni List br. 28/2008), clan 6, clan 7 Zakona o Obrazovanju i Obuku za odrasle br. 04/L-143 (Sluzbeni List br. 02/2013), clan 12 paragraf 12.1 slovo (ë), clan 27 slovo (ç,nj) Opstinskog Statuta br. 98 dana 17.08.2012, donosi:

ODLUKU

**Za usvajanje predloga br. 348 dana 15.04.2017 za koriscenje finansijskih sredstava za neformalnu nastavu**

1. Usvaja se predlog za otvaranje budzetske linije u ekonomskoj kategoriji 11 za plate.
2. Finansijska sredstva u ukupnom iznosu od 18.597.24 € kao samostalni prihodi u obrazovanju destiniraju se za isplatu nastavnika i obrazovnog osoblja koji su drzli i odrzavaju nastavni proces, ispite neformalne nastave i alociraju se u ekjonomskoj kategoriji 11 u srednjem obrazovanju kao: u srednjem obrazovanju za Srednju Tehnisku Skolu "Minatori" kod programa br. 94231 iznos od 4.920.34 €, u srednjem obrazovanju za Ekonomsku Srednju Skolu "Hoxhë Kadri Prishtina" kod programa br. 94232 iznos od 6.948.22 € i srednjem obrazovanju za Srednju Skolu "Hivzi Sulejmani" kod programa br. 94233 iznos 6.728.68 €.
3. Izvrsavanje i nadzor ostalih procedura je u nadleznosti Gradonacelnika Opstine, Direkcije za Finansije i Budzet i Direkcijie za Obrazovanje.
4. Ova odluka stupa na snagu 15 dana posle upisa na protokol Ministarstva Administracije Lokalne Samouprave kao i objavljivanja na sluzbenim jezicima na web stranici Opstine.

**Akt da se prosledi: Gradonacelniku Opstine, Predsedavajuceg Skupstine Opstine, Direkciji za FB, Direkciji za Obrazovanje i Arhivi.**

**Predsedavajuci Skupstine Opstine**
**Dr. sc. Fadil Krasniqi**

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE
DREJTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU
Nr.faq/Br.str. 80
Datë/Datum. 11. 05. 2017
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE

**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA**
**REPUBLIC OF KOSOVA**

Fushë kosova

**KOMUNA E FUSHË–KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE**
**MUNICIPALI TY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE**

**Datë: 05.05.2017**

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 28.04.2017, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 350, të datës 19.04.2017, të paraqitur nga Kryetari i Komunës, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, shkronja (nj), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

**V E N D I M**

**Për aprovimin e 'Propozimit për hapjen e procedurave me partneritet publiko-privat dhe studimin e fizibilitetit për ndërtimin e objektit në Ngastrën Kadastrale Nr. 00773-2 në Fushë-Kosovë'.**

1. Për aprovimin e 'Propozimit për hapjen e procedurave me partneritet publiko-privat dhe studimin e fizibilitetit për ndërtimin e objektit në Ngastrën Kadastrale Nr. 00773-2, në sipërfaqe të përgjithshme prej 00.26.45ha, në Zonën Kadastrale Fushë-Kosovë, në hapësirën ekzistuese të pronës dhe objektit të Shtëpisë së Kulturës në Fushë-Kosovë'.

2. Ndërtimi i objektit të ri, me partneritet publiko-privat, propozohet të jetë me etazhitet P+10+NK dhe do të jetë simboli i qytetit të Fushë-Kosovës, pas caktimit dhe përzgjdhjes së projektit ideor përmes procedurës së ofertimit publik. Objekti do të jetë në funksion dhe do të përdoret nga institucionet publike të komunës si: Arkivi Komunal, Muzeu Komunal, Biblioteka, Salla për Lexim, Salla për Teatër, Salla për Film, Salla për Ekspozita, Galeria e Arteve, hapësira për Shoqërinë Civile, hapësira për subjektet politike të përfaqësuara në Kuvendin e Komunës, hapësira për Shoqatat Humanitare, Shoqatat Sportive, e tjera.

3. Kryerja e procedurave tjera për hapjen e ofertave publike, dizajnimi i strukturës teknike dhe arkitektonike të objektit të ri, i cili do të ndërtohet duke e mbështetur në dispozitat ligjore të Ligjit për Partneritet Publiko-Privat dhe lejimi i projektit nga Komisioni përkatës i Ministrisë së Financave, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Financave e Buxhetit, Drejtorisë së Planifikimit Urban, Drejtorisë së Gjeodezisë, Kadastrit dhe Pronës dhe Drejtorisë së Administratës - Zyrës së Prokurimit.

4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

**Akti i dorëzohet:** **Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së FB, Drejtorisë së PU, Drejtorisë së GJKP, Drejtorisë së Administratës dhe Arkivës.**

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**
**Dr.sc. Fadil Krasniqi**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË KOSOVËS / OPSTINA KOSOVO POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË KOSOVË / KOSOVO POLJE

Nr.faq/Br.str. 80
Datë/Datum. 11.05.2017
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE

Datum 05.05.2017

Skupstina Opstine na sastanku odrzanog dana 28.04.2017 posle razmatranja predloga br. 350 dana 19.04.2017 godine, predstavljenog od strane Gradonacelnika Opstine, razmotrenog na Komitetu za Politiku i Finansije i Komitetu za Zajednice, oslanjajuci se na clan 11, clan 40 paragraf 40.2 slovo (I) Zakona o Lokalnoj Samoupravi br. 03/L-040 (Sluzbeni List br. 28/2008), clan 27 slovo (nj) Opstinskog Statuta br. 98 dana 17.08.2012, donosi:

ODLUKU

**Za usvajanje predloga za otvaranje procedura za privatno javni partneritet i studiranje fizibiliteta za izgradnju objekta na katastarskoj parceli br. 00773-2 u Kosovo Polje**

1. Za usvajanje predloga za otvaranje procedura za privatno javni partneritet i studiranje fizibiliteta za izgradnju objekta u katastarskoj parceli br. 00773-2 u ukupnoj povrsini od 00.26.45 ha u katastarskoj zoni Kosovo Polje u postojecem prostoru imovine i objektu Doma Kulture u Kosovo Polje.
2. Izgradnja novog objekta u privatno javnom partneritetu predlaze se da bude sa tazitetotm od P+10+PK i bice simbol grada Kosovo Polje posle odredjivanja i izbora ideornog projekta preko procedura javne ponude Opstine kao: opstinska arhiva, opstinski muzej, biblioteka, sala za citanje, sala za teatar, sala za filmove, sala za izlozbe, proctor za civilno drustvo, proctor za politicke subjekte predstavljenim u Skupstini Opstine, proctor za humanitarne organizacije, sportska drustva i dr.
3. Izvrsavanje i nadzor ostalih procedura za otvaranje javnih ponuda, dizajniranje tehnicke i arhitektonske strukture novog objekta koji ce biti izgradjen oslanjajuci se na zakonskim dispozicijama Zakona o Privatno Javnom Partneritetu i odobravanje projekta od nadlezne komisije i Ministarstva za Finansije je u nadleznosti Gradonacelnika Opstine, Direkcije za Finansije i Budzet, Direkcije za Urbanisticko Planiranje, Dirkecije za Geodeziju, Katastar i Imovinu i Direkcije za Administraciju-Kancelarija za Javnu Nabavku.
4. Ova odluka stupa na snagu 15 dana posle upisa na protokol Ministarstva Administracije Lokalne Samouprave kao i objavljivanja na sluzbenim jezicima na web stranici Opstine.

**Akt da se prosledi: Gradonacelniku Opstine, Predsedavajuceg Skupstine Opstine, Direkciji za UP, Direkcijiza FB, Direkciji za GKI, Direkciji za Administraciju i Arhivi.**

**Predsedavajuci Skupstine Opstine**
**Dr. sc. Fadil Krasniqi**